

V E N D I M

PËR RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot, ne datë 18/11 / 2005, unë gjyqtarja e Gjykatës së Shkalles se Pare Tiranë, Regleta Panajoti, pasi studjova kërkesën e paraqitur nga Z. Arian Kraja, Kryetar i Bordit Drejtues (Drejtor i Përgjithshëm) i "INSTITUTIT AMERIKAN TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË – AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA", si dhe te gjithë dokumentacionin bashkengjur kërkesës:

K O N S T A T O V A:

Se, Z. Arian Kraja, Kryetar i Bordit Drejtues (Drejtor i Përgjithshëm) i "INSTITUTIT AMERIKAN TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË – AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA", ka bërë kërkesë për rregjistrimin si person juridik të "INSTITUTIT AMERIKAN TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË – AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA" ne formën e një shoqërie anonime.

Kjo shoqëri do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin Nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit No.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve", ndryshimeve të tij, si dhe akteve të tjera nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

Kohëzgjatja e këtij aktiviteti sikurse është përcaktuar edhe në Statutin e shoqërisë është pa afat. Forma e shoqërisë do të jetë shoqëri anonime pa ofertë publike. Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në adresën Rr."Dervish Hima", P 11/k, Tiranë, Shqipëri dhe shoqëria në të ardhmen mund të hapë filiale apo degë të saj edhe ne qytete të tjera të RSH-së ose në vende të tjera jashtë saj.

Në përputhje me lejen e marrë për ushtrimin e aktivitetit, Nr.2, Datë 07.07.2005 nga Inspektoriati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, si dhe në mbështetje të Nenit 4, pika 2.b. të Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A. do të zhvillojë veprimtarinë si institut privat pensionesh suplementare i formës "*Institut Privat Pensionesh i Hapur*".

Në përputhje me dispozitat e Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", për të realizuar aktivitetin e vet tregtar, "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A. mund të:

- a) kryejë çdo operacion financiar për investimin dhe menaxhimin e mjeteve financiare për llogari të saj apo për llogari të klientëve në përputhje me objektin veprimtarisë, si dhe lejen e marrë, si dhe standartet e menaxhimit të riskut;
- b) kryejë çdo operacion lidhur me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme për llogari të saj apo për llogari të klientëve;
- c) kryejë çdo aktivitet të dobishëm apo të nevojshëm për realizimin e objektit të Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos kryhen në tejkalim të atyre të përmendura më sipër;
- d) kryejë publikime dhe reklamime;
- e) marrë, direkt apo indirekt, interesa në shoqëri të tjera, të cilat mund të kenë qëllim të njëjtë me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", për të arritur qëllimet e përmendura, përveç aktiviteteve kryesore, si dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit No. 7632, datë 04.11.1992, "Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A. mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tjetër favorizues, ndihmës, aksesor, lehtësues, përfitues, aksidental dhe okazional, i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimtarisë së Shoqërisë.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 70.000.000 (shtatëdhjetë milion) Lekë. Kapitali themeltar i Shoqërisë është ndarë në 10.000. (dhjetë mijë) aksione të barazvlefshme, me vlerë nominale prej 7.000 (shtatë mijë) Lekë për një aksion. Kapitali ndahet si më poshtë:

1. **Fondi Shqiptar - Amerikan i Ndërmarrjeve** zotëron 51 % (pesëdhjetëenjë përqind) të kapitalit themeltar të nënshkruar, të barazvlefshëm me 5100 (pesëmijë e njeqind) aksione.
2. **Artan Dulaku Sh.p.k.** zotëron 49 % (dyzet e nente përqind) të kapitalit themeltar të nënshkruar, të barazvlefshëm me 4900 (katërmijë e nenteqind) aksione.

Kapitali Themeltar është shlyer në të holla në masën 35.7 % (tridhjetë e pesë pike shtatë përqind) të totalit ose 25.000.000 leke (njetzet e pesë milion leke)

Nga të cilat:

- Fondi Shqiptar - Amerikan i Ndermarrjeve ka shlyer 18.2 % (tetëmbëdhjetë pike dy përqind) të totalit të vlerës së kapitalit themeltar ose 12.750.000 leke (Dymbëdhjetë milion e shtatëqindpesëdhjetëmijë leke);
- Artan Dulaku Sh.p.k. 17.5 % (shtatëmbëdhjetë pike pesë përqind) të totalit të kapitalit themeltar ose 12.250.000 leke (Dymbëdhjetë milion e dyqinde pesëdhjetëmijë leke).

Po ashtu, në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit No.7943, datë 01.06.1996, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve", Shtuar dhe ndryshuar me Ligjin No.8393, datë 02.09.1998, Neni 6, themeluesit kane ngurtësuar pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, një shumë garancie prej 10 milionë lekë të reja për tre vjet, provuar kjo me dokumentin e lëshuar nga Banka Amerikane e Shqipërisë. Këshilli i parë Mbikqyrës do të ketë këtë përbërje:

- | | |
|--------------------|--------------------|
| 1. Jeffrey Griffin | Kryetar |
| 2. Artan Dulaku | Zv/ Kryetar i Parë |
| 3. Adrian Dulaku | " |
| 4. Greta Angjeli | " |
| 5. Martin Mata | " |
| 6. Ridvana Mara | " |
| 7. Arian Leskaj | " |

Kryetar i Bordit Drejtues (Drejtor i Përgjithshëm) është Z. Arian Kraja, i datëlindjes 10 Gusht 1965, Lindur në Tiranë dhe banues në Rr.Pjeter Bogdani, P. 7/1, Tiranë

Ekspert kontabël i autorizuar i Shoqërisë do të jetë Z.Kosta Nika me No.3 License.

PER KETO ARSYE

Meqënëse është paraqitur i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe meqënëse unë gjyqtarja i gjej ato të plotësuar në përputhje me Ligjin Nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit No.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve", ndryshimeve të tij, si dhe akteve të tjera nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij,

V E N D O S A:

Të pranoj kërkesën e Z. Arian Kraja, Kryetar i Bordit Drejtues (Drejtor i Përgjithshëm) i "INSTITUTIT AMERIKAN TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË – AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA", për rregjistrimin si person juridik të "INSTITUTIT AMERIKAN TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË – AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA" në formën e një shoqërie anonime, duke urdhëruar rregjistrimin e saj në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Aktiviteti i kësaj shoqërie do të zhvillohet në përputhje me Ligjin Nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit No.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve", ndryshimeve të tij, si dhe akteve të tjera nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij

Kohëzgjatja e këtij aktiviteti, sikurse është përcaktuar edhe në Statutin e shoqërisë është pa afat. Forma e shoqërisë do të jetë shoqëri anonime pa ofertë publike. Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në adresën Rr."Dervish Hima", P 11/k, Tiranë, Shqipëri dhe shoqëria në të ardhmen mund të hapë filiale apo degë të saj edhe në qytete të tjera të RSH-së ose në vende të tjera jashtë saj.

Në përputhje me lejen e marrë për ushtrimin e aktivitetit, Nr.2, Datë 07.07.2005 nga Inspektoriati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, si dhe në mbështetje të Nenit 4, pika 2.b. të

Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A. do të zhvillojë veprimtarinë si institut privat pensionesh suplementare i formës "Institut Privat Pensionesh i Hapur".

Në përputhje me dispozitat e Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", për të realizuar aktivitetin e vet tregtar, "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A. mund të:

- f) kryejë çdo operacion financiar për investimin dhe manaxhimin e mjeteve financiare për llogari të saj apo për llogari të klientëve në përputhje me objektin veprimtarisë si dhe lejen e marrë si dhe standartet e menaxhimit të riskut;
- g) kryejë çdo operacion lidhur me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme për llogari të saj apo për llogari të klientëve;
- h) kryejë çdo aktivitet të dobishëm apo të nevojshëm për realizimin e objektit të Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos kryhen në tejkalim të atyre të përmendura më sipër;
- i) kryejë publikime dhe reklamime;
- j) marrë, direkt apo indirekt, interesa në shoqëri të tjera, të cilat mund të kenë qëllim të njëjtë me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", për të arritur qëllimet e përmendura, përveç aktiviteteve kryesore, si dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit No. 7632, datë 04.11.1992, "Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A. mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tjetër favorizues, ndihmës, aksesori, lehtësues, përfitues, aksidental dhe okazional, i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimtarisë së Shoqërisë.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 70.000.000 (shtatëdhjetë milion) Lekë. Kapitali themeltar i Shoqërisë është ndarë në 10.000. (dhjetë mijë) aksione të barazvlefshme, me vlerë nominale prej 7.000 (shtatë mijë) Lekë për një aksion. Kapitali ndahet si më poshtë:

1. **Fondi Shqiptar - Amerikan i Ndërmarrjeve** zotëron 51 % (pesëdhjetëenjë përqind) të kapitalit themeltar të nënshkruar, të barazvlefshëm me 5100 (pesëmijë e njëqind) aksione.
2. **Artan Dulaku Sh.p.k.** zotëron 49 % (dyzet e nente përqind) të kapitalit themeltar të nënshkruar, të barazvlefshëm me 4900 (katërmijë e nenteqind) aksione.

Kapitali Themeltar eshte shlyer në të holla ne masen 35.7 % (tridhjetë e pesë pike shtatë perqind) të totalit ose 25.000.000 leke (njetzet e pesë milion leke)

Nga te cilat:

- Fondi Shqiptar - Amerikan i Ndermarjeve ka shlyer 18.2 % (tetembedhjetë pike dyperqind) te totalit te vleres se kapitalit themeltar ose 12.750.000 leke (Dymbedhjetë milion e shtateqindpesedhjetemije leke);
- Artan Dulaku Sh.p.k. 17.5 % (shtatembedhjetë pike peseperqind) te totalit te kapitalit themeltar ose 12.250.000 leke (Dymbedhjetë milion e dyqinde pesedhjetëmije leke).

Po ashtu, në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit No.7943, datë 01.06.1996, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", Shtuar dhe ndryshuar me Ligjin No.8393, datë 02.09.1998, Neni 6, themeluesit kane ngurtësuar pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, një shumë garancie prej 10 milionë lekë të reja për tre vjet, provuar kjo me dokumentin e lëshuar nga Banka Amerikane e Shqipërisë.

Këshilli i parë Mbikqyrës do të ketë këtë përbërje:

1. Jeffrey Griffin	Kryetar
2. Artan Dulaku	Zv/ Kryetar i Parë
3. Adrian Dulaku	"
4. Greta Angjeli	"
5. Martin Mata	"
6. Ridvana Mara	"
7. Arian Leskaj	"

Kryetar i Bordit Drejtues (Drejtor i Përgjithshëm) është Z. Arian Kraja, i datëlindjes 10 Gusht 1965, Lindur në Tiranë dhe banues në Rr.Pjeter Bogdani, P. 7/1, Tiranë

Ekspert kontabël i autorizuar i Shoqërisë do të jetë Z.Kosta Nika me No.3 License.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

Tirane dt/8/ 7 / 2005

GJYQTARE
Regjete Hajdari
Alphonse

33825

URDHER - REGJISTRIMI

1- Emertimi: *Instituti Amerikan; Personori*
Arvete Suplementare te Shpirtit "S.H.A."

2- Selia: *Devide Hokeo PHHKE. Tenua*

3- Objekti: *Amerikan - Mbledhje me qepta regjere*
te konfidencales LP43011/16/2005

4- Kapitali: *25.000.000 (Myzet e qe me shume jehes*
te detyrues me bashk me Amerikan & Shpirtit

5- Mandat Arketimi *in 0007RF 2051020007 } dt 11-7-2005*
0006DLK051920083

6- Administrator i shoqerise:

7- Ortaket: *Shkronet: 1) Fondi Shpirtit - Amerikan; detyra*
Amazn: 51%
2) Kateri Duket qe 49%

8- Kohezgjatja: *pa qe*

9- Statuti eshte nenshkuar ne dt *20 jete 4077/1136 dt 7/7/2005*


10- Nr fleteve Akt themelimi: *Shkrt in 4078/1137 dt 7/7/2005 M Soory*

11- Nr fleteve Statuti: *20 fete*

12- Rregjistruar ne dt: *18-07-2005*

13- Shenime *M. Hokeo emu*

M. Hokeo
M. Hokeo
M. Hokeo
GJYQTARE
Regjete Perder
gy



AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ANONIME

“INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENARE TË SHQIPËRISË” – AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A.

Aksionaret themelues jane si me poshte:

- 1. FONDI SHQIPTAR - AMERIKAN I NDËRMARJEVE**
- 2. ARTAN DULAKU SH.P.K.**

Në mbështetje të Ligjit No.7638, datë 19.11.1992, “Për Shoqëritë Tregtare”, Ligjit No.7943, datë 01.06.1995, “Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve”, amendamenteve të ligjeve të sipër përmendura, akteve nënligjore nxjerrë në zbatim të tyre, standarteve ndërkombëtare, praktikave më të mira financiare, të marrëveshjes midis ortakëve dhe të statutit, themeluesit bien dakord të krijojnë dhe rregjistrojnë këtë shoqëri tregtare anonime si Institut Privat të Pensioneve Suplementare.

1 – Krijimi, Emërtimi, Kohëzgjatja dhe Forma Juridike e Shoqërisë

- 1.1 “INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA** krijohet si një shoqëri tregtare anonime.
- 1.2 Emërtimi i shoqërisë është “INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A.**
- 1.3 Kohëzgjatja e “INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A.** është pa afat.
- 1.4 “INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPËRISË” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A.** është shoqëri anonime pa ofertë publike.

2 -- Selia

Aksionarët themelues te shoqërisë **“INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A.** janë dakord që selia e shoqërisë te jetë në adresën Rr. “Dervish Hima”, P.11/k, Tiranë.



3 -- Objekti

- 3.1 Në përputhje me lejen e marrë për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në mbështetje të Nenit 4, pika 2.b. të Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", "**INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË**" - **AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.** ka të drejtë:

**Të zhvillojë veprimtarinë si institut privat pensionesh
suplementare i formës "Institut Privat Pensionesh i Hapur"**

- 3.2 Në përputhje me dispozitat e Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", për të realizuar aktivitetin e vet tregtar, "**INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË**" - **AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.** mund të:
- a) kryejë çdo operacion financiar për investimin dhe manaxhimin e mjeteve financiare për llogari të saj apo për llogari të klientëve në përputhje me objektin veprimtarisë si dhe lejen e marrë si dhe standartet e menaxhimit të riskut;
 - b) kryejë çdo operacion lidhur me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme për llogari të saj apo për llogari të klientëve;
 - c) kryejë çdo aktivitet të dobishëm apo të nevojshëm për realizimin e objektit të Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos kryhen në tejkalim të atyre të përmendura më sipër;
 - d) kryejë publikime dhe reklamime;
 - e) marrë, direkt apo indirekt, interesa në shoqëri të tjera, të cilat mund të kenë qëllim të njëjtë me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë.
- 3.3 Në përputhje me dispozitat e Ligjit no.7943, datë 01.06.1995, "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", për të arritur qëllimet e përmendura, përveç aktiviteteve kryesore, si dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit No. 7632, datë 04.11.1992, "Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", "**INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË**" - **AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.** mund të kryej çdo lloj aktiviteti tjetër favorizues, ndihmës, aksesor, lehtësues, përfitues, aksidental dhe okazional, i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimtarisë së Shoqërisë.

4 -- Kapitali Themeltar

- 4.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 70.000.000 (shtatëdhjetë milion) Lekë

4.2

Kapitali themeltar i Shoqërisë është ndarë në 10.000. (dhjetë mijë) aksione të barazvlefshme, me vlerë nominale prej 7.000 (shtatë mijë) Lekë për një aksion.

4.3 Kapitali ndahet si më poshtë:

1. **Fondi Shqiptar - Amerikan I Ndërmarjeve** zotëron 51 % (pesëdhjetëenjë përqind) të kapitalit themeltar të nënshkruar, të barazvlefshëm me 5100 (pesëmijë e njeqind) aksione.
2. **Artan Dulaku Sh.p.k.** zotëron 49 % (dyzet e nente përqind) të kapitalit themeltar të nënshkruar, të barazvlefshëm me 4900 (katërmijë e nenteqind) aksione.

4.4 Kapitali Themeltar është shlyer në të holla në masën 35.7 % (tridhjetë e pesë pike shtatë përqind) të totalit ose 25.000.000 leke (njetzet e pesë milion leke)

Nga të cilat:

- Fondi Shqiptar - Amerikan i Ndermarjeve ka shlyer 18.2 % (tetëmbëdhjetë pike dy përqind) të totalit të vlerës së kapitalit themeltar ose 12.750.000 leke (Dymbëdhjetë milion e shtatëqindpesëdhjetëmijë leke).
- Artan Dulaku Sh.p.k. 17.5 % (shtatëmbëdhjetë pike pesë përqind) të totalit të kapitalit themeltar ose 12.250.000 leke (Dymbëdhjetë milion e dyqindë pesëdhjetëmijë leke)

5 - Organet e Drejtimit dhe të Administrimit

5.1 Shoqëria funksionon, kontrollohet dhe drejtohet nga:

- a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve;
- b) Këshilli Mbikëqyrës
- c) Bordi Drejtues

Këto do të jenë organet e “**INSTITUTIT AMERIKAN TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË**” - **AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.**, të cilat do të përgjigjen për funksionimin, kontrollimin dhe drejtimin e saj, në përputhje me statutin e shoqërisë dhe akteve të tjera të saj.

5.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

5.3 Këshilli Mbikëqyrës emëron antaret e Bordit Drejtues të shoqërisë, miraton të gjitha aktet e brendshme rregullative të “**INSTITUTIT AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË**” - **AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.**, politikat dhe procedurat e investimeve të fondeve të “**INSTITUTIT AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË**” - **AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.**, si dhe mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e Bordit të Drejtoreve.

5.3.1 Këshilli Mbikëqyrës i raporton Asamblesë se Përgjithshme të Aksionerëve për përmbushjen e të gjitha funksioneve dhe detyrave të tij.

5.4 "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A." drejtohet nga Bordi Drejtues. Bordi Drejtues përgjigjet për administrimin e menaxhimin e "INSTITUTIT AMERIKAN TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A.

5.4.1 Bordi Drejtues drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm qe eshte eprori direkt i te gjithë Drejtorëve të tjerë. Drejtoria ka strukturën e mëposhtme: Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare dhe Financës, i cili eshte Zv/Kryetar i Bordit Drejtues, Drejtori i Departamentit të Kontributeve dhe Statistikes, Drejtori i Departamentit te Çështjeve Ligjore, Drejtori i Departamentit te Informatikes dhe Teknologjise.


5.4.2 Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë përgjigjet për drejtimin dhe administrimin e përditshëm të "INSTITUTIT AMERIKAN TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A. Drejtori i Përgjithshëm është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë në marrënie me të tretët.

5.5 "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA S.H.A. ka komitet kontrolli. Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre antare, që emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe ushtrojnë detyrat e përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore.


6 - Dispozita përfundimtare

Akt themelimi hyn në fuqi në datën e regjistrimit në regjistrin tregtar.

Aksionerët


Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndërmarrjeve
Jeffrey T. Griffin
PRESIDENT & CEO

F O N D I
SHQIPTARO AMERIKAN
I NDERMARJEVE
TIRANE ALBANIA


Artan Dulaku
ARTAN DULAKU
ADMINISTRATOR



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 4176 Regj.

Vërtetohet fotokopja
me origjinalin

TIRANE

FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE

AKT THEMELIMI

I

PULLE TAKSE



FONDI SHQIPTARO – AMERIKAN I NDERMARRJEVE, shoqate e organizuar sipas ligjeve te shtetit Delaware, verteton si me poshte:

E para – Emri i shoqates eshte FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN I NDERMARRJEVE (Shoqatea)


E dyta – Shoqata ka kohezgjatje te perhershme.

E treta – Adresa e selise se shoqates ne shtetin e Delaware eshte 1209 Orange Street, ne Qytetin e Wilmington, Kontea e New Castle.

E katerta – Objekti I shoqates eshte te ndermarre cdo aktivitet te ligjshem te cilin e parashikon legjislacioni I shtetit te Delaware. Objekti I vecante per te cilin eshte krijuar shoqata eshte: (i) te ndihmoje zhvillimin e sektorit privat ne Shqiperi, duke vene theksin ne ndermarrjet e mesme dhe te vogla, ndermarrjet e perbashketa ndermjet pjesemarrsesve te Shteteve te Bashkuara dhe Shqiperise, dhe politikat dhe praktikat favorizuese te zhvillimit te sektorit privat ne Shqiperi, nepermjet huave, dhurimeve, investimeve, studimeve metodike, asistences teknike, trainimeve, sigurimeve, garancive dhe mjeteve te tjera dhe (ii) te çoje me tej te gjitha qellimet dhe politikat dhe te jete ne perputhje me Aktin per Ndhimen ne Demokracine e Europes Lindore 1989, e cila me tutje do te quhet Akti Meme. Pavaresisht nga sa me siper, shoqatea nuk do te merret me asnje aktivitet te cilat nuk do te jene te lejuara nga Akti Meme apo nga ndonje perjashtim I shoqatese nga tatimi mbi te ardhurat sipas seksionit 501 (c) (3) I Kodit te te Ardhurave te Brendeshme te 1986 apo parashikimet perkatese te ndonje legjislacioni tjeter mbi taksat (Kodi).

E pesta – Shoqata do te jete shoqate anetaresie, nuk do te jete fitimprurese dhe nuk do te kete autoritetin per te nxjerre aksione nga kapitali. Anetaret e shoqatese (veç e veç Anetari, dhe bashkarisht Anetaret) do te jene Drejtoret amerikan (term I percaktuar ne nenin 8 me poshte) te percaktuar kohe pas kohe. Nese kohe pas kohe dhe per çdo arsye çdo anetar do te heqe dore nga te qenurit si Drejtor, ai njekohesisht nuk do te jete as anetar I shoqatese.

E gjashta – Aktiviteti, prone dhe çeshtje e shoqates do te drejtohet nga Bordi I Drejtoreve te shoqates, do te parashikoje qe autoriteti i tyre nuk do te ushtrohet nga ose ndermjet tij por do te ushtrohet nga ose ndermjet atyre personave qe kohe pas kohe do te jene Drejtoret amerikane: (i) adoptimi, amendamentet apo revokimi I Statutit te Shoqatese, (ii) amendimi I Aktit te Themelimit dhe (iii) rekomandimet anetareve per likuidimin e shoqates dhe dispozitave te pronesis se ne perputhje me kete Akt themelimi, Akti Meme



dhe Kodi. Per qellimin e ushtrimit te kompetencave te mesiperme, do te kerkohet nje vote mazhoritare e drejtove amerikane.


E shtata – Kualifikimi, zgjedhja, numri, mbajtja, pushtetet dhe detyrat e drejtove do te parashikohen ne kete akt themelimi. Perdorimi i termit “Bordi i tere i Drejtove”, ketu do t’i referohet numrit te pergjithshem te drejtove qe do te kete shoqatea ne rast se nuk do te kete vende bosh.

E teta – bordi i drejtove te shoqates do te jete i perbere nga qytetare amerikane te zgjedhur ne baze te aktit meme dhe nenit 10 me poshte (drejtoret amerikane) dhe qytetare shqiptare zgjedhur ne baze te aktit meme dhe nenit 11 me poshte (drejtoret shqiptare). Ne perputhje me aktin meme te gjithe drejtoret duhet te demostrojne eksperience dhe kualifikim ne zhvillimin e sektorit privat ku Shoqatea mund te perfshihet. Numri I drejtove amerikane dhe atyre shqiptare te cilet do te perbejne bordin e drejtove do te jete nje numer jo me pak se 3 (tre) dhe jo me teper se 15 (pesembdhjete), si te caktohet nga vota e drejtove te cilet do te perbejne shumicen e te gjithe bordit te drejtove. Drejtoret do te caktohen me te pakten nje anetar me pak sipas nenit 10 (dhjete) dhe 11 (njembdhjete) ketu me poshte.

E nenta Drejtoret do te qendrojne ne detyre per nje afat 3 (tre) vjecar dhe me pas deri ne ate periudhe qe zevendesuesit e tyre do te zgjidhen dhe do te kualifikohen apo deri sa ata te japin doreheqjen. Çdo drejtor i cili do te zgjidhet per-te zevendesuar vendet bosh ne bordin e drejtove ose i cili do te emerohet do te sherbeje per nje afat te metejshem. Zgjedhja e drejtove nuk ka nevoje te behet me vote te shkruar.

E dhjeta – Emrat dhe adresat e drejtove amerikane jane shkruar ne nenin 18 ketu me poshte. Jo me vone se 30 dite perpara mbarimit te afatit te drejtove amerikane dhe sa me shpejt te jete e mundur pas konstatimit te vendit bosh ne detyren e drejtorit amerikan, kryetari do te kerkoje keshillen e presidentit te Shteteve te Bashkuara apo te emeruarit te tij (me poshte referuar si president i ShBA) persa i perket zgjedhjes se drejtove amerikane te shoqatese te cilet do te qendrojne ne detyre per nje afat te papercaktuar apo ne rast te nje vendi pushim. Me anen e nje lajmerimi, Kryetari do te vere ne dijeni menjehere per mbledhjen e anetareve e cila do te kete per qellim zgjedhjen e drejtove pasardhes, plotesimin e vendit bosh apo vendime te tjera te ngjashme me keto.

E njembdhjeta – Menjehere pas dates se percaktuar me pare, anetaret duhet te zgjedhin Drejtoret shqiptare mbasi te kene marre lajmerimin e te jene konsultuar me pare sipas ketij neni. Jo me vone se 30 dite perpara perfundimit te afatit per zgjedhjen e drejtove shqiptare e sa me shpejte pas plotesimit te ndonje vendi bosh ne rolin e ndonje drejtori shqiptar, Kryetari duhet te kerkoje nga Presidenti i Shteteve te Bashkuara nje njoftim lidhur me zgjedhjen e drejtove shqiptare, njoftim i cili duhet te permbaje percaktimin e kushteve te reja apo nje afat te ri ne rast te nje vendi te ri bosh. Ne perputhje me dokumentin SEED, çdo qytetar shqiptar i cili nuk respekton rregullat e demokracise e te nje tregu te lire, nuk mund te zgjidhet si Drejtor i shoqatese. Me marrjen e nje lajmerimi te tille, Kryetari duhet te lajmeroje pa vonese per mbledhjen e anetareve e cila do te kete si qellim zgjedhjen e drejtorit pasardhes apo plotesimin e ndonje vendi bosh.



E dymbëdhjeta – Secili drejtor amerikan apo shqiptar mund të shkarkohet në çdo moment, me ose pa shkak, nëpërmjet votimit të shumicës së anëtarëve

E trembëdhjeta – Çdo vend bosh në Bordin e drejtuesve do të plotësohet në përputhje me procedurat e percaktuara në nenin 10 me sipër apo në atë 11, sipas rastit.

E katërmbëdhjeta – Masat e mara për rregullimin e punëve të brendshme të shoqatës, me përjashtim të çka është parashikuar në këtë Akt Themelimi, do të vendosen sipas statuteve të shoqatës apo sipas udhëzimeve të Bordit drejtues në bazë të statuteve.

E pesëmbëdhjeta – Asnjëri nga drejtoret apo anëtarët e tjerë nuk do të jetë personalisht përgjegjës për dëme monetare, humbje të kredibilitetit në detyrën e drejtorit, me përjashtim të rasteve kur drejtori është përgjegjës sipas seksionit 174 të ligjit për shoqatete të shtetit të Delaware, apo të ndonjë akti pasardhës, ose do të konsiderohet përgjegjës në rast se shkel detyrimin e ndërshterësive të shoqatës apo kur nuk vepron me mirëbesim, apo kur kryen shkelje të ligjit, apo kur përfiton personalisht në mënyrë jo të pastër me kryerjen e ndonjë tranzaksioni. Çdo ndryshim apo anulim i këtij neni, apo ndërmarrja e masave të tjera që nuk përputhen me këtë nen, do të eliminojnë apo zvogëlojnë rolin e këtij neni, ashtu si edhe çdo veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 15.

E gjashtëmbëdhjeta – Asnjë pjesë e të ardhurave apo të fondeve të shoqatës nuk do të përdoret nga ndonjëri prej anëtarëve të Bordit të Drejtoreve, anëtarë, nepunës, apo persona të tjerë, me përjashtim të rasteve kur shoqataea do të jetë e autorizuar të paguajë paga apo shpërblime të arsyeshme (përfshirë këtu edhe bonuse apo çmime të ndryshme) për shërbimet e kryera e në rast të kryerjes së pagesave në përputhje me qëllimet e nënvizuara në nenin 4 me sipër. Aktiviteti i shoqatës nuk do të jetë aspak kryerja e propagandave ose prekja e ligjeve, shoqataea nuk do të marrë pjesë apo nuk do të ndërhyjë (përfshirë shpërndarjen apo publikimin e fletëpalosjeve) në asnjë fushatë politike në mbështetje apo kundër ndonjë kandidati shtetëror. Pavarësisht nga ndonjë masë e percaktuar në aktin e themelimit, shoqataea nuk do të kryejë ndonjë aktivitet të palejuar sipas parashikimeve të seksionit 501, (c) (3) të tatimit federal të të ardhurave, të kodit ose (ii) nga një shoqatë të ardhurat e të cilës janë të zbritëshme sipas seksionit 170 (c)(2) të këtij kodi.

E shtatëmbëdhjeta – Çdo likuidim apo shpërndarje e shoqatës dhe shpërndarje e asetëve të saj do të ndodhë jo më shpejt se 10 (dhjetë) vjet dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet nga data e themelimit të shoqatës derisa nuk bihet dakort ndryshem me shkrim midis Anëtarëve të shoqatës dhe Presidentit të Shteteve të Bashkuara ose të emëruarit të tij pas konsultimit me Kongresin. Procedura për çdo likuidim, shpërndarje ose ndryshim të shoqatës do të bëhet si më poshtë: (i) pas konsultimit me Anëtarët e shoqatës, Presidenti i Shteteve të Bashkuara ose i emëruari i tij do të njoftojë shoqatën për datën e caktuar për perfundimin e shoqatës ("Dita e perfundimit") të pakten 12 muaj para Dites së perfundimit ("Njoftimi"). (ii) pas marrjes së njoftimit, shoqataea mund të vazhdojë të bëjë vetëm ato detyra ose investime që janë në proces për t'u marrë në konsideratë në Ditën e njoftimit por

shoqatea nuk do te transferoje asetet e saj te asnje nga deget e saj ose persona dhe shoqate te tjera me qellim perjashtimin e ketyre asetete nga likuidimi ose shperndarja e shoqatase; (iii) ne ose para Dites se perfundimit, shoqatea do te filloje shperndarjen e puneve dhe shitjen e aseteteve ne menyre te rregullt dhe do t'i paraqese Presidentit te Shteteve te Bashkuara ose personit te emeruar prej tij per ta shqyrtuar dhe marre miratimin e tij nje plan Perfundimi persa i perket menyres se si do te kryhet dhe ditën e caktuar kur do te perfundoje shitja e rregullt e aseteteve te shoqatase (Plani i Perfundimit); sidoqofte duhet pasur parasysh se kohezgjatja e Planit te Perfundimit mund te zgjatet nga Presidenti i Shteteve te Bashkuara ose personi i emeruar nga ky i fundit, per arsye regjistrimi ose zhvillimi; (iv) Presidenti i Shteteve te Bashkuara ose personi i emeruar prej tij mund ta aprovoje Planin e Perfundimit duke e modifikuar ose jo ose mund te vendose per nje Plan Perfundimi te ndryshem nga ai qe i eshte paraqitur; dhe (v) pas Dites se Perfundimit te saj, Shoqatea nuk mund te marre asnje lloj angazhimi dhe nuk mund te kryeje asnje investim pa miratimin paraprak me shkrim nga Presidenti i Shteteve te Bashkuara ose personi i emeruar prej tij. Asetet e Shoqatase te krijuara nga permbushja e Planit te Perfundimit ose per arsye te tjera mund te shpermdahen kur te behen te disponueshme ose pas shitjes se aseteteve te Shoqatase dhe, ne çdo rast, siç percaktohet ekskluzivisht nga Presidenti i Shteteve te Bashkuara ose personi i emeruar prej tij (edhe sikur Shoqatea te beje rekomandime) ne favor te (a) nje personi juridik qe nuk ka qellime fitimi ose personave juridike qe ndihmojne Shqiperine; (b) Qeverise se Shteteve te Bashkuara ose (c) kombinimeve te (a) dhe (b). Pavaresisht nga sa me siper, Presidenti i Shteteve te Bashkuara ose personi i emeruar prej tij ruajne te drejten per te caktuar Diten e Perfundimit ne çdo kohe per shkak ose per arsye te politikës se jashtme duke njoftuar me shkrim Shoqatene, duke perdorur gjuhen e perdorur ne Marreveshjen e Dhurimit AID.

E tetembedhjeta Emrat dhe adresat e drejtoreve te pare te Shteteve te Bashkuara te cilet do te sherbejne si drejtores derisa zevendesuesit e tyre te zgjidhen dhe kualifikohen ose deri ne doreheqjen ose zevendesimin e tyre me te shpejte, jane:

BORDI I FONDIT SHQIPTARO – AMERIKAN TE NDERMARRJEVE

Domenick G. Scaglione, themelues dhe drejtor ekzekutiv i Intercontinental Associates Inc., firme keshilluese tregtie dhe investimi.

Tel: (212) 758-8100

Fax: (212) 758-8957


Thomas Lambert Cranmer, ndihmes thesarbajtes i degeve te huaja te eksplorimit te Mobil Oil Corporation zv.kryetar i U.S. Business Council per Europen Jugore dhe Lindore.

Tel: (703) 846-4345

Fax: (703) 846-5699

James H. Duffy, autor i pavarur dhe ish jurist partner ne Cravath, Swaine & Moore.

Tel: (212) 744-8885



Fax: (212) 288-3139

Calvin Grigsby, Kryetar dhe Drejtor Ekzekutiv i Grigsby Brandford and Company, banke investimesh ne San Fransisco.

Tel: (415) 392-4800

Fax: (415) 398-5548

Michael D. Granoff, themelues dhe Drejtor Ekzekutiv i Pomona Capital, fond privat investimesh.

Tel: (212) 867-7150

Fax: (212) 867-6802

Herta Lande Seidman, bashke-themelues dhe kryetar i Tradenet Corporation dhe ish Asistent Sekretar per Tregtine, Shtetet e Bashkuara, Departamenti i Tregtise.

Tel: (212) 843-0040

Fax: (212) 842-1485



Rodney B. Wagner, Zv.Kryetar dhe drejtor i J. P. Morgan.

Tel: (212) 648-3737

Fax: (212) 648-5204

Enentembedhjeta Emri dhe adresa e themeluesit te vetem te shoqates eshte Domenick G. Scaglione, c/o Intercontinental Associates Inc., 14 East 60th Street, New York, N.Y. 10022.

Ne prani te deshmitareve, i nenshkruari ka ekzekutuar rregullisht kete Akt Themelimi me 24th Mars 1995.

Domenick G. Scaglione
Themelues i vetem
(Signature)

Perktheu nga anglishtja



STATUTI
I
“INSTITUTIT AMERIKAN TE PENSIONEVE PRIVATE
SUPLEMENTARE TE
SHQIPERISE” – AMERICAN PENSION FUND OF
ALBANIA SH.A.

Statuti i “INSTITUTIT AMERIKAN TW PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE” – AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A. bazohet ne Ligjin No.7638, datë 19.11.1992, “Për Shoqëritë Tregtare”, Ligjit No.7943, datë 01.06.1995, “Për Pensionet Supplementare dhe Institutet Private te Pensioneve”, amendamenteve të ligjeve të sipër përmendura, akteve nenligjore nxjerre ne zbatim te ligjeve, standarteve nderkombetare, praktikave me te mira financiare dhe ne marreveshjen e ortakeve aksionere.

DISPOZITA THEMELORE


Neni 1 - Krijimi dhe forma juridike e Shoqërisë

- 1 **“INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.** eshte person juridik privat, me aksionere Fondin Shqiptar Amerikan te Ndermarrjeve, zoterues i 5100 aksioneve dhe Artan Dulaku Sh.p.k., zoterues i 4900 aksioneve, me vlere nominale 7000 leke per nje aksion..
- 2 **“INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.** eshte shoqeri anonime pa oferte publike.
- 3 **“INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.** e ushtron veprimtarine ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 2 - Emërtimi i Shoqërisë

- 1 Emërtimi i shoqerise eshte **“INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.** (me poshte “Shoqeria”).
- 2 Emërtimi i shoqerise **“INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TE SHQIPERISE” - AMERICAN PENSION FUND OF ALBANIA SH.A.** në formë të shkurtuar eshte **“I.A.P.P.S.SH.- APFA” SH.A..**

Neni 3 - Selia, Filialet, Deget, Agjencite dhe Zyra e Perfaqesimit.

- 
- 1 Selia e Shoqërisë është në Rr. "Dervish Hima" P.11/k., Tiranë. Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionereve mund të vendose nëse selia dhe drejtoria mund të jenë në vendodhje të ndryshme.
 - 2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të vendose në lidhje me hapjen ose mbylljen e selive dytësore. Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionereve mund të vendose edhe për transferimin e selisë së shoqërisë. Bordi Drejtues propozon dhe publikon transferimin e selisë. Procedurat dhe publikimi i transferimit përcaktohet nga Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionereve. Transferimi i selisë dhe ndryshimet në aktet e Shoqërisë hyn në fuqi në momentin e regjistrimit në Rregjistrin Tregtar.
 - 3 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të vendose për hapjen ose mbylljen e filialeve të Shoqërisë në Shqipëri apo dhe jashtë saj.
 - 4 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të vendose për hapjen ose mbylljen e degeve të Shoqërisë në Shqipëri apo dhe jashtë saj.
 - 5 Asambleja e Jashtëzakonshme mund të vendose për hapjen ose mbylljen e çdo dege, agjencie dhe zyre përfaqësimi, të përhershme apo jo të përhershme, në Shqipëri.
 - 6 Përsa i përket marrëdhënieve midis Shoqërisë dhe aksionerëve, vendbanimi i secilit prej aksionerëve është ai i përcaktuar në regjistrin e aksionerëve. Rregjistri i Aksioneve do të mbahet në selinë e Shoqërisë, me adresë Rr. "Dervish Hima" P11/k, Tirane.

Neni 4 - Logo dhe Vula


- 1 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve me propozim të Keshillit Mbiqyres përcakton logon dhe vulën e Shoqërisë.
- 2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të ndryshojë pjesërisht ose plotësisht logon dhe vulën e Shoqërisë.

Neni 5 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.

Neni 6 - Objekti

- 1 Në përputhje me lejen e marrë, Shoqëria ka të drejtë:



Mbulimin me përfitime suplementare ne perputhje me ligjin nr.7943, date 1.6.1995 "Per Pensionet Suplementare dhe Institutet Private te Pensioneve", ne rastet e lindjes së të drejtës për këto përfitime ne shtese te atyre qe jepen nga ligji nr. 7703, date 11.05.1993 "Per sigurimet shoqerore në Republikën e Shqipërisë".

Shoqeria nuk do të angazhohet ne asnjë veprimtari tjetër, e cila nuk parashikohet ne legjislacionin e mësipërm.

2 Në përputhje me legjislacionin tregtar, për të arritur qëllimet e përmendura, Shoqëria mund të:

- a) kryejë çdo operacion, perfshire investimin, zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme për llogari të saj dhe për llogari të klientëve;
- b) kryejë çdo operacion lidhur me pasuri të luajtshme për llogari të saj dhe për llogari të klientëve;
- c) kryeje çdo aktivitet të dobishëm apo të nevojshëm per realizimin e objektit te Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos kryhen në tejkalim të objektit të përmendur më sipër;
- d) kryejë publikime dhe reklamime;
- e) marrë, direkt apo indirekt, interesa në shoqëri të tjera, të cilat mund të kenë qëllim të njëjtë me atë të Shoqërisë, dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën financiare.

3 Në përputhje me legjislacionin tregtar, për të arritur qëllimet e përmendura, pervec aktiviteteve kryesore, shoqeria mund të kryeje çdo aktivitet tjetër favorizues, ndihmes, aksesori, lehtësues, perfitues, aksidental dhe okazional i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm me qëllim që të realizohet objekti i veprimtarisë së Shoqërisë.


Neni 7 - Perfitimi dhe pjesemaresit

1. Çdo sigurim suplementar do te jete vullnetar, i bazuar ne nje kontrate individuale.
2. Person i siguruar do te quhet personi i siguruar ne lidhje me sigurimin suplementar, qe:
 - a. ka mbushur moshen 18 vjeç;
 - b. ka banim te perhershem ne Republiken e Shqiperise;
 - c. ka lidhur nje kontrate me shkrim me institutin e pensioneve.

Personat me banim jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, mund te sigurohen ne institutet private te pensioneve me kusht qe ne rast mosmarreshjesh te zbatohet legjislacioni shqiptar. Pjesemarrja ne sigurimin suplementar do te jete vullnetare.

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONERET - AKSIONET

Neni 8 - Kapitali Themeltar

- 
- 1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 70.000.000 leke (shtatedhjete milion leke)
 - 2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është kapital i cili përbëhet nga 10.000 (dhjetemije) aksione te barazvlefshme, me vlerë nominale prej 7.000 (shtatemije leke) për çdo aksion.
 - 3 Asamblea e Jashtezakonshme e Aksionereve, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë statut, mund të ndryshojë kapitalin si më poshtë:
 - a. të zmadhojë kapitalin nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja në atë shumë sa e gjykon të pranueshme;
 - b. të konsolidojë dhe të ndajë çdo ose të gjitha pjesët e kapitalit në aksione me vlerë më të madhe se sa aksionet ekzistuese;
 - c. të konvertojë çdo ose të gjitha aksionet e shlyera në aksion leter me vlerë dhe të rikonvertojë aksionin leter me vlerë në aksion të thjeshtë të shlyeshëm;
 - d. të anullojë aksionet, të cilat në ditën e shfuqizimit, nuk janë marrë apo nuk janë pranuar për t'u marrë nga çdo person, duke zvogeluar kapitalin në masën e aksioneve të shfuqizuara.
- Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji, ndryshimi i kapitalit bëhet nga Asamblea e Jashtezakonshme e Aksionereve.
- Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve përcakton mënyrën e ndryshimit të kapitalit, metodën e emetimit dhe të shpërndarjes së aksioneve, si dhe çmimin e këtyre aksioneve.
- Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë statut, vendos mbi mënyrën e ndryshimit të akt themelimit dhe të Statutit.
- 4 Në zmadhimin e kapitalit, aksionerët kanë të drejtë përparësie në nënshkrim për rritjen e kapitalit, proporcionalisht me shumën e aksioneve që zoterojnë.
 - 5 Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerëve mund të zvogelojë kapitalin e Shoqërisë. Në të gjitha rastet, zvogelimi i prek aksionerët në të njëjtën masë në përpjestim me vlerën e aksioneve që zoterojnë. Zvogelimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet nga:
 - a. vecimi dhe ulja e detyrimit për çdo aksion kur nuk është paguar;
 - b. anulimi i çdo aksioni të shlyer, i cili ka humbur ose nuk përfaqëson asnjë pjesë të disponueshme të aktivitetit të Shoqërisë;
 - c. pagimi i çdo pjesë të kapitalit aksioner që përben tepër mbi nevojat e Shoqërisë për kapital.


6. Asamblea e Jashtëzakonshme e Aksionereve me zvogelimin e kapitalit ndryshon statutin sipas ndryshimeve perkatese ne kapitalin aksioner dhe ne aksionet e Shoqërisë.

Neni 9 - Aksionet

- 1 Aksionet e Shoqërisë jane nominale dhe te pandashme.
- 2 Cdo aksion i Shoqërisë njih te drejten e nje vote.
- 3 Aksionet e Shoqërisë mund te prezantohen ne formen e certifikates. Certifikata eshte "*prima facie*" vertetim pronesie i aksionit ne Shoqëri. Certifikata nenshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblese, Kryetari i Keshillit Mbikeqyres dhe nje anetar i Bordit Drejtues i percaktuar nga Keshilli Mbikeqyres. Certifikata vulozet me vulen e Shoqërisë.
- 4 Keshilli Mbikeqyres mund të udhëzojë që të lëshohet një certifikatë e re në vend të ndonjë certifikate të lëshuar më parë nga Shoqëria të konsideruar të humbur ose të shkatërruar (demtuar). Kur autorizohet lëshimi i një certifikate të re, Keshilli Mbikeqyres, me diskrecionin e saj dhe si një kusht paraprak për lëshimin e tyre, mund të përcaktojë afatet dhe kushtet që konsiderohen të përshtatshme, dhe mund të kërkojë dëshmipërblimet e konsideruara të përshtatshme, për të mbrojtur Shoqërinë nga ndonjë padi e cila mund të ngrihet kundër saj lidhur me certifikatat të cilat pretendohen të kenë humbur ose të jetë shkatërruar.
- 5 Aksioni konsiderohet i zotuar nga aksioneri me plotesimin e kerkesave ligjore dhe me fitimin e se drejtes se pakushtezuar per tu rregjistruar ne rregjistrin e aksionereve te Shoqërisë.

Neni 10 - Aksioneret

- 1 Aksioneret i ushtrojne te drejtat dhe detyrimet mbi aksionet e zoteruara ne te gjitha mbledhjet e Asamblese se Shoqërisë.
- 2 Pergjegjësia e aksionerit per detyrimet e shoqerise kufizohet deri ne vleren nominale te aksionit te nenshkruar.
- 3 Ne rast se nje aksion zoterohet nga me shume se nje zoterues, atehere te drejtat dhe detyrimet mbi kete aksion ushtrohen nga perfaqesuesi. Perfaqesuesi emerohet nga te gjithë zoteruesit dhe i komunikohet me shkrim e Shoqërisë. Ne mungese te perfaqesuesit, te drejtat dhe detyrimet e zoteruesve mbi aksionin pezullohen deri ne emerimin e tij.
- 4 Transferimi "*inter vivos*" i aksioneve të Shoqërisë i nënshtrohet të drejtës së parablerjes në favor të aksionerëve të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë brenda 20 ditësh nga marrja e letrës së dërguar me postë që përmban ofertën.



Përcaktimet që parashikohen në këtë Nen nuk do të zbatohen për shitjet dhe transferimet e kryera nga aksionerët në favor të aksionerëve të tjerë. Megjithatë, në këtë rast, transferimi duhet t'i njoftohet më parë aksionerëve të tjerë me shkrim. Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë Nen duhet t'i adresohen edhe Shoqërisë. Oferta për transferimin "*inter vivos*" të aksionit është e vlefshme për 20 dite kalendarike dhe brenda këtij afati është e përvokueshme.

5 Në rast se Shoqëria emeton dhe ofron aksionet e saj përgjate ushtrimit të veprimtarisë, atëherë këto aksione i ofrohen personave të tjerë vetëm kur :

- a) i ofrohen paraprakisht personave që zoterojnë aksionet në Shoqëri. Këto aksione ofrohen me kushte të njëjta apo të favorshme dhe në vlerë të përafert me vlerën nominale të aksionit në kohën e emetimit.
- b) afati i parashikuar për pranimin apo refuzimin e ofertës për personat që zoterojnë aksionet në Shoqëri ka mbaruar. Afati konsiderohet i mbaruar edhe kur aksionerët kanë njoftuar Shoqërinë për pranimin apo refuzimin e ofertës.

ORGANIZIMI, ADMINISTRIMI DHE DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 11 - Organet e Drejtimit dhe Administrimit

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga këto organe vendimarrëse dhe drejtuese:

Asambleja e Përgjithshme
Këshilli Mbikqyres
Bordi Drejtues

1. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga dy dhoma:

- a) dhoma e aksionerëve;
- b) dhoma e përfaqësuesve të personave të siguruar. (Me përfaqësues të aderuesve)


Çdo dhomë zgjedh anëtarët e vet në Këshillin Mbikqyres. Dhoma e aksionerëve ka veton për çdo vendim të Asamblesë së Përgjithshme.


1/1. Përfaqësuesit e personave të siguruar zgjidhen me votim të fshehtë nga të siguruarit një herë në 5 vjet.

2. Çdo aksionmbajtës do të ketë aq vota sa numri i aksioneve që ai zoteron në institutin e pensioneve.

3. Asambleja e përgjithshme:

- a) do të zgjedhë anëtarët e keshillit mbikqyres të institutit të pensioneve dhe do të kërkojë nga inspektoriat miratimin e tyre;
- b) do të miratojë statutin e institutit të pensioneve;
- c) do të miratojë raportin vjetor të institutit të pensioneve;
- d) do të miratojë bilancin vjetor të institutit të pensioneve.

- 
4. Asambleja e pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit per te miratuar:
 - a) raportin vjetor te institutit te pensioneve;
 - b) bilancin vjetor, llogarite;
 - c) raportin e keshillit mbikqyres per veprimtarine ekonomike te institutit te pensioneve;
 - d) ndryshimet e shtesat ne statutin dhe rregulloren e pensioneve;
 - e) dhe per te analizuar ne çdo 2 vjet veprimtarine e institutit te pensioneve ne raport me parashikimet afatgjata.
 5. Personat e siguruar do te perfaqesohen nga persona fizike te zgjedhur ne ndermarrjet e punedhenesve (punedhenesit) qe zoterojne aksionet e institutit te pensioneve.
 6. Perfaqesuesit do te zgjidhen nje here ne 4 vjet nga te siguruarit. Zgjedhjet do te organizohen me interesimin e punedhenesit. Kandidatet do te caktohen nga sindikatat ose nga çdo grup punonjesish prej jo me pak se 10 vetash.
 7. Asambleja e Aksionereve eshte organi me i larte vendim-marrës i Shoqërisë.
 8. Asambleja e Aksionerëve perfaqesohet dhe përbëhet nga të gjithë aksionerët e Shoqërisë.
 9. Asambleja e Aksionereve vendos ne pergjithesi per te gjitha ceshtjet e Shoqërisë. Vendimet e Asamblese se Aksionereve jane te detyrueshme per te gjithë aksioneret, keshillin mbikeqyres, Bordin Drejtues dhe punonjesit, agjentet apo perfaqesuesit e Shoqërisë.
 10. Asambleja e Aksionerëve mund të jetë e Zakonshme apo e Jashtëzakonshme.
 11. Asambleja e Aksionereve mblidhet ne seline e Shoqërisë. Asambleja e Aksionerëve mund të mblidhet edhe në një vend të ndryshëm nga selia.
 12. Asambleja e Aksionerëve thirret nga Kryetari i Asamblese me propozim te Keshillit Mbikeqyres apo te Bordit Drejtues apo sipas kerkesave të ligjit. Thirrja e Asamblesë së Aksionerëve rregullohet nga Ligji. Propozuesi harton rendin e mbledhjes. Nje ose disa aksionere qe zoterojne se bashku jo me pak se 5% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise mund te propozojne shtesa apo ndryshime ne rendin e mbledhjes.
 13. Asambleja e Aksionereve mund te thirret nga Kryetari i Asamblese me propozim te nje ose me shume aksionereve qe zoterojne se bashku jo me pak se 10% te kapitalit te nenshkruar te shoqerise. Propozuesi harton rendin e mbledhjes.
 14. Asambleja e Aksionerëve do të konsiderohet e thirrur në mënyrën e duhur edhe nëse nuk janë respektuar formalitetet që rregullojnë procedurën e thirrjeve, me kusht që të gjithë Aksionerët janë të pranishëm apo përfaqësohen me prokurë dhe të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikeqyres, Drejtorët dhe Kontrolluesit janë të pranishëm.

- 
15. Aksionerët të cilët janë regjistruar që prej të paktën 5 (pesë) ditësh në regjistrin e aksionerëve dhe aksionerët të cilët depozitojnë aksionet e tyre në bazë të udhëzimeve dhe afateve të përcaktuara në njoftimin e thirrjes mund të marrin pjesë në Asamblesë e Aksionerëve. Njoftimi i thirrjes duhet t'u japë mundësinë aksionerëve të huaj të depozitojnë aksionet e tyre në një bankë, e cila duhet të jetë korrespondente e një banke të autorizuar, të ndodhur në vendin ku aksioneri i huaj ka vendbanimin sipas regjistrin të aksionerëve. Në këtë rast, aksioneri i cili dëshiron të ndjekë mbledhjen e asamblesë, duhet të depozitojë çertifikatën e depozitimit të aksioneve në bankë në vend të aksioneve.
 16. Të gjitha mbledhjet Asamblesë së Aksionerëve drejtohen nga Kryetari i Asamblese apo në vend të tij nga Zëvendës-Kryetari, ose, nëse këta persona nuk janë të disponueshëm, nga një aksioner i emëruar nga Asambleja e Aksionerëve. Asambleja e Aksionerëve cakton një sekretar të mbledhjes, i cili mund të jetë ose jo aksioner.
 17. Aksionerët mund të përfaqësohen në Asamblesë e Aksionerëve, me një prokurë të shkruar, nga një aksioner tjetër ose nga bashkëshorti/ja e tij/saj. Megjithatë, çdo aksioner apo person i tretë nuk mund të përfaqësojë më shumë se tre aksionerë të tjerë.
 18. Kryetari ka kompetenca të plota për të verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtën e aksionerëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve dhe të vendosë nëse ajo është e mbledhur rregullisht dhe nëse është i pranishëm *quorum*-i i aksionerëve me qëllim që të merren vendime të vlefshme; ai ka gjithashtu të drejtën të drejtojë diskutimet dhe të përcaktojë metodat dhe procedurat e votimit.
 19. Proçes-verbalet e mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga sekretari.

Neni 12 – Asambleja e Zakonshme

1. Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve duhet të mbahet të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve nga fundi i vitit financiar, me qëllim që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen raportet financiare të vitit të mëparshëm financiar.
2. Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve quhet vlefshmërisht e mbledhur në mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë Aksionerët, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zotërojnë ose perfaqesojnë të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se ky *quorum* nuk arrihet, mund të mbahet një mbledhje e dytë, pa u kërkuar ndonjë *quorum*.
3. Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve merr vendim me shumicën e votave të vlefshme të aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar. Votat e vlefshme nuk përfshijnë votat e aksionerit i cili nuk merr pjesë në votim ose ka abstenuar ose e paraqet të bardhe ose të ndotur.

4. Asamblea e Zakonshme e Aksionereve vendos ne vecanti per ceshtjet e meposhtme:

- a. emeron anetaret e Keshillit Mbikeqyres dhe cakton kohezgjatjen e funksioneve te tyre;
- b. shkarkon Keshillin Mbikeqyres dhe Bordin e Drejtuesve nga detyrimi financiar per funksionet e kryera ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise;
- c. te miratoje buxhetin, llogarite, raportin vjetor dhe dokumentat e tjera financiare te shoqerise;
- d. te emeroje ekspertin kontabel te autorizuar;
- e. te emeroje Komitetin e Kontrollit
- f. te miratoje marreveshje te binjakezimit per administrimin dhe drejtimin e shoqerise;
- g. te percaktoje shperblimin e anetareve te Keshillit Mbikeqyres, Bordit Drejtues dhe te Komitetit te Kontrollit.

Ceshtjet e mesiperme mund te vendosen apo amendohen nga asambleja e jashtezakonshme e aksionereve, por me kusht qe te prezantohen ne mbledhjen e rradhes se asamblese se zakonshme te shoqerise.

Neni 13 - Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme

- 1 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve quhet e thirrur vlefshmërisht në mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë Aksionerët, të pranishëm ose të përfaqësuar, të cilët zotërojnë ose perfaqesojne të paktën 50% (pesëdhjetë përqind) të aksioneve me të drejtë vote, dhe në mbledhjen e dytë nëse marrin pjesë Aksionerë, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zotërojnë ose perfaqesojne të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote.
- 2 Në rast se ky *quorum* nuk arrihet, mbledhja e dytë mund të shtyhet për një datë të mëvonshme, por jo më vonë se 2 muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë.
- 3 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve vendos me shumicë votash prej 3/4 (tre të katërtat) qe u perkasin aksionerëve të pranishëm apo të përfaqësuar.
- 4 Mbledhja e Asamblesë së Jashtezakonshme të Aksionerëve merr vendim me shumicën e votave te vlefshme te aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar. Votat e vlefshme nuk perfshijne votat e aksionerit i cili nuk merr pjese ne votim ose ka abstenuar ose e paraqet te bardhe ose te ndotur.
- 5 Asamblea e Jashtezakonshme e Aksionereve vendos ne vecanti per ceshtjet e meposhtme:
 - a. te ndryshoje statutin e shoqerise. Cdo ndryshim i statutit behet me shumicen e votave por jo me pak se 3/4 e votave te vlefshme te aksionereve.
 - b. te miratoje marrjen persiper te mjeteve, detyrimeve apo borxheve financiare te shoqerise;
 - c. te miratoje shperndarjen, bashkimin, ndarjen, shkrirjen e shoqerise;
 - d. te miratoje krijimin e filialeve dhe te degeve jashte Shqiperise te shoqerise.

Asamblea e jashtezakonshme e aksionereve pervec kur percaktohet ndryshe ne ligj dhe ne dispozitat e ketij statuti, vendos per te gjitha ceshtjet e asamblese se aksionereve te shoqerise.

Neni 14

Keshilli Mbikqyres

1. Keshilli mbikqyres perbehet nga 7 anetare, nga te cilet 5 anetare zgjidhen nga aksioneret dhe 2 anetare nga perfaqesuesit e personave te siguruar ne Asamblene e Pergjithshme. Perfaqesuesit e aksionereve, anetare te Keshillit mbikqyres, zgjedhin kryetarin dhe zevendes kryetarin e pare te tij. Perfaqesuesit e personave te siguruar ne Keshillin mbikqyres zgjedhin zevendes kryetarin e dyte te tij. Ne rast se ata nuk bien dakort per nje gje te tille, Kryetari emerone njerin prej tyre si zevendes kryetar te dyte te Keshillit mbikqyres. Anetaret e Keshillit mbikqyres zgjidhen per nje afat 5 vjeçar.

2. Keshilli mbikqyres:

- a) zgjedh anetaret e bordit drejtues;
- b) vendos per investimet e medha, kufiri i te cilave percaktohet nga asambleja e pergjithshme;
- c) kerkon raporte te rregullta nga bordi drejtues;
- d) raporton ne asamblene e pergjithshme;
- e) perberja e keshillit mbikqyres se pare ndodhet ne Aneksin A bashkelidhur.

3. Shoqëria kontrollohet nga Keshilli Mbikqyres.

4. Keshilli Mbikqyres miraton politikat e veprimtarise dhe kufijte e operacioneve te shoqerise.


5. Keshilli Mbikqyres, pervec kur percaktohet ndryshe ne kete statut, pergjigjet per administrimin e Shoqërisë dhe vendos per te gjitha ceshtjet e deleguara nga Asamblea e aksionereve. Keshilli drejtues vendos edhe per ceshtjet te cilat nuk jane percaktuar shprehimisht per Asamblene e Aksionereve. Per keto vendime Keshilli njofton Asamblene dhe vendimi hyn ne fuqi tre muaj pas dates se njoftimit.

6. Keshilli Mbikqyres, pervec kur percaktohet ndryshe ne kete statut, pergjigjet per mbikqyrjen e menaxhimit te Shoqerise.

7. Keshilli Mbikqyres emerone dhe shkarkon Bordin Drejtues dhe nepunesit drejtues te shoqerise.


8. Keshilli Mbikqyres kontrollon dhe mbikqyr :

- a. zbatimin e ligjit, akteve nenligjore, akteve te asamblese se pergjithshme dhe akteve te vete keshillit;
- b. financat e shoqerise;
- c. funksionimin e strukturave organizative te shoqerise;
- d. veprimtarine e Bordit Drejtues.

- 
9. Këshilli Mbikeqyres rishikion dhe mbikëqyr çdo situatë aktuale apo të mundshme konflikti interesash dhe, në përputhje me ligjin, merr prej anëtarëve të Bordit Drejtues të gjitha njoftimet e konflikteve aktuale apo të mundshme të interesave apo interesave materiale që ata mund të kenë me Shoqërinë. Këshilli Mbikeqyres nxjerr udhëzime në lidhje me ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetit për informacionet në lidhje me Shoqërinë si dhe kontrollon zbatimin e tyre.
 10. Këshilli Mbikeqyres ka të drejtë të kryejë të gjitha verifikimet dhe mbikqyrjet që i quan të përshtatshme për përmbushjen e detyrave të tij.
 11. Këshilli Mbikeqyres i paraqet Asamblesë së Zakonshme komentet e tij mbi raportin vjetor të nxjerrë nga Bordi Drejtues.
 12. Këshilli Mbikeqyres miraton kriteret e marrjes në punë, vendet e punës dhe shpërblimet e punonjësve të Shoqërisë dhe jep autorizimin për lidhjen e marrëveshjeve që kërkojnë autorizim në bazë të ligjit.

Neni 15 - Përbërja, Afati, Shkarkimi dhe Emërimi i Anëtarëve

1. Anëtarët e Këshillit Mbikeqyres ushtrojnë kompetencat për një periudhë jo më të gjatë se pesë vjet. Anëtarët e keshillit mbikeqyres mund të rizgjidhen.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikeqyres nuk mund të marrin pjesë në më shumë se 5 (pesë) Këshilla Mbikqyrës apo Drejtues të tjerë të shoqërive, të cilat kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Anëtari i Këshillit Mbikeqyres mund të shkarkohet nga detyra në rast se :
 - a. denohet nga gjykata për një veprë të dënueshme;
 - b. falimenton apo është në procedurë të paafetisë pague;
 - c. është i paafte fizikisht dhe mendërisht;
 - d. mashtron shoqërinë;
 - e. mungon në vazhdimësi dhe pa shkak të arsyeshëm më shumë se një vit kalendarik;
 - f. shkel rëndë etikën dhe cenon interesat e shoqërisë;
 - g. deklarohen si të papërshtatshëm për administrimin dhe menaxhimin e shoqërisë për shkak të :
 1. shpërdorimit të detyrës ndaj shoqërisë;
 2. shkeljes së detyrimit të besnikërisë ndaj shoqërisë;
 3. çdo keqpërdorimi të aktiveve të shoqërisë;
 4. çdo keqadministrimi të pasurisë të shoqërisë, aksionerëve, klientëve kreditorë apo debitorë;
 5. çdo sjellje që shkakton keqpërdorim apo keqadministrim të aktiveve të shoqërisë dhe të pasurive si me sipër;
 6. çdo sjellje që shkakton detyrim të pajustificuar për shoqërinë;


- 
7. mos deklarimit te konfliktit te interesave dhe te interesave te tjera qe lidhen me veprimtarine e shoqerise;
 8. mos pergatitjes ne kohe te llogarive vjetore, bilancit dhe pasqyrave financiare te shoqerise;
 9. kryerjes se veprimeve qe perbejne shkak per paaftesi paguese te shoqerise;
 10. mos permbushjes ne kohe te detyrimeve te shoqerise megjithese eshte paguar;
 11. perfundimit te operacioneve ne vlerë me te vogel se operacionet normale;
 12. perfitimeve personale dhe te ardhurave te ekzagjeruara ne rast se shoqeria eshte ne veshtiresi financiare
4. Në rast vdekjeje, shkarkimi apo dorëheqje, vendet vakant duhet të zëvendësohen brenda jo më shumë se 3 muajve. Anëtar i Këshillit mbikeqyres, i emëruar për të zëvendësuar një anëtar tjetër, do të qëndrojë në detyrë për të gjithë kohën e mbetur të mandatit të paraardhësit.

Neni 16 - Kryetari, Zëvendës Kryetari dhe Sekretari

- 1 Kryetari dhe ne mungese te Kryetarit, Zëvendës Kryetari kanë për detyrë të thërrasin mbledhjet e Këshillit dhe të drejtojnë diskutimet.
- 2 Këshilli Mbikeqyres emëron një Zëvendës-Kryetar nga anëtarët e tij. Zevendes Kryetari emërohet për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhet.
- 3 Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Këshillit mund të marrin shpërblim shtesë, të caktuar nga Këshilli.
- 4 Këshilli mbikeqyres mund të emërojë një sekretar.
- 5 Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit drejtohen nga Zëvendës-Kryetari.


Neni 17 - Mbledhjet e Këshillit Mbikeqyres

- 1 Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres zhvillohen si rregull i pergjithshem cdo muaj kalendarik por jo me pak se nje here ne tre muaj kalendarik.
- 2 Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres zhvillohen ne pranine e jo me pak se gjysmes plus nje anetar te keshillit drejtues por jo me pak se 4 (kater) anetare.
- 3 Vendimet e Keshillit Mbikeqyres merren me shumicen e thjeshte te votave. Ne rast barazie votash, vota e kryetarit te Keshillit eshte percaktuese.
- 4 Kryetari do të thërrasë Këshillin Mbikeqyres brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga kërkesa e motivuar e Drejtorisë ose të 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të Këshillit. Nëse kjo kërkesë mbetet pa përgjigje, kërkuesi mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit, duke përcaktuar rendin e saj të ditës.
- 5 Thirrja bëhet 3 (tre) ditë para mbledhjes, me anë të një letre, telegrami, teleksi apo telefaksi. Thirrja mund të jetë e vlefshme edhe kur është gojore apo bëhet në çdo moment, nëse anëtarët e Këshillit e pranojnë atë. Çdo thirrje përmban rendin e ditës të propozuar të mbledhjes.
- 6 Mbledhjet e Këshillit Mbikeqyres zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çfarëdo vendi tjetër të treguar në thirrje.

- 
- 7 Proçes-verbali mbahet nga sekretari dhe nënshkruhet nga ai dhe nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyres. Proçes-verbalet mbahen në një regjistër të veçantë.
 - 8 Rregullat te detajuara do te percaktohen ne rregulloren e veprimtarise se institutit te pensioneve.
 - 9 Anetaret e Keshillit Mbikëqyres mbajne ndaj shoqerise pergjegjesi te perbashket apo edhe individuale sipas rastit, per vendimet qe ata marrin kur rezultojne ne kundershtrim me dispozitat ligjore, per shkelje te statutit, si dhe per gabime te bera gjate administrimit te shoqerise. Pergjegjësia e anetareve te Keshillit Mbikëqyres për këto raste percaktohet ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 18 - Bordi Drejtues

1. Bordi Drejtues do te perbehet nga 5 anetare te afte profesionalisht, te zgjedhur nga keshilli mbikqyres. Nje nga keta anetare do te zgjidhet si kryetar dhe nje tjetër si zevendes kryetar. Kryetari eshte perfaqesues i institutit te pensioneve. Te drejtat dhe detyrimet e tyre do te percaktohen ne statut.
2. Bordi Drejtues:
 - a) drejton institutin e pensioneve;
 - b) ndermerr veprime financiare;
 - c) raporton ne Keshillin Mbikqyres.
3. Rregullat te detajuara do te percaktohen ne rregulloren e bordit drejtues.
4. Bordi Drejtues perbehet nga Drejtori i Pergjithshem qe eshte Kryetar i Bordit Drejtues, Drejtori i Departamentit te Operacioneve Monetare dhe Finances qe eshte Zv/Kryetar i Bordit Drejtues, Drejtori i Departamentit te Kontributeve dhe Statistikes, Drejtori i Departamentit te Ceshtjeve Ligjore, Derjtori i Departamentit te Informatikes dhe Teknollogjise.
5. Anetare te Bordit Drejtues nuk mund te jene dhe anetare te Keshillit Mbikëqyres.
6. Kryetari i Bordit Drejtues pergjigjet per menaxhimin dhe administrimin e perditshem te Shoqërisë. Kryetari i Bordit Drejtues pergjigjet per realizimin e te gjitha detyrave te ngarkuara nga Keshilli Mbikëqyres.
7. Kryetari i Bordit Drejtues perfaqeson ligjërisht shoqërinë. Këshilli Mbikëqyres per ceshtje te vecanta mund te autorizojë perfaqesimin e shoqerise nga dy drejtues se bashku.
8. Kryetari i Bordit Drejtues detyrohet te informoje Keshillin Mbikëqyres per veprimtarine dhe administrimin e perditshem te shoqerise. Keshilli Mbikëqyres percakton me akt te vecante detyrimet e Kryetarit te Bordit Drejtues dhe procedurat per informimin e Keshillit Mbikëqyres. Pavaresisht, Kryetari i Bordit Drejtues ne menyre te vecante detyrohet si me poshte:

- 
- a. te informoje Keshillin Mbikeqyres per veprimtarine e shoqerise;
 - b. te pergatite dhe paraqese ne Keshill Mbikeqyres pasqyrat financiare peridike;
 - c. te propozoje buxhetin vjetor ne Keshill Mbikeqyres;
 - d. te propozoje planin e biznesit ne Keshill Mbikeqyres;
 - e. te informoje Keshillin Mbikeqyres per cdo ndryshim ne aktet ligjore dhe nenligjore qe prekin veprimtarine e shoqerise;
 - f. te informoje periodikisht nje here ne muaj Keshillin Mbikeqyres per marredheniet e shoqerise me IIPPS dhe organet e tjera publike qe lidhen me veprimtarine eshoqerise;
 - g. te informoje Keshillin Mbikeqyres per cdo fakt ose ngjarje qe ka ose mund te preke veprimtarine e shoqerise

- 10 Kryetari i Bordit Drejtues emerom dhe shkarkon personelin e shoqerise sipas kritereve te percaktuara nga Keshilli Mbikeqyres. Shperblimi i personelit caktohet nga Kryetari i Bordit Drejtues sipas kritereve te percaktuara nga Keshilli Mbikeqyres.
- 11 Përfaqësuesit e mësipërm ligjorë të shoqërisë mund të emërojnë një përfaqësues “*ad negotia*” për ushtrimin e detyrave apo kategorive të detyrave të veçanta, brenda kufijve të kompetencave të dhëna.
- 12 Në rast të ndonjë vendi vakant në Bordin Drejtues për shkak vdekje, dorëheqje, shkarkimi, mungese kualifikimi apo çdo shkak tjetër, pasardhësit do të zgjidhen nga Këshilli Mbikeqyres në mbledhjen e parë që ndjek lënien vakant të vendit. Pasardhësi do të përfundojë mandatin e personit në vendin e të cilit ai është emëruar. Nëse shumica e anëtarëve heq dorë nga detyra, prezumohet se i gjithë Bordi i Drejtues ka hequr dorë dhe si rrjedhim Këshilli Mbikeqyres duhet menjëherë të procedojë për emërimin e një Bordi Drejtues të ri.
- 13 Bordit Drejtues i jepen të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji apo Statuti ia rezervon organeve të tjera. Bordit Drejtues i nënshtrohet mbikqyrjes dhe kontrollit të Këshillit Mbikeqyres.
- 14 Kryetari i Bordit Drejtues dhe Zevendes Kryetari i Bordit Drejtues shkarkohet nga detyra ne rast se vertetohen rrethanat e parashikuara ne piken 14.4. Kryetari i Bordit Drejtues dhe Zevendes Kryetari i Bordit Drejtues shkarkohet edhe per shkak te nderprerjes se marredhenieve te punes me Shoqërinë.
- 15 Drejtoria do të mbajë llogaritë e duhura dhe do të pregatisë pasqyrat financiare në përputhje me ligjin. Bordi Drejtues do t'i paraqesë një raport Këshillit Mbikeqyres të paktën një herë në tre muaj. Bordi Drejtues do t'i paraqesë Këshillit Mbikeqyres llogaritë vjetore të paktën brenda tre muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 19 – Sekretit dhe konfidencialiteti

Përveç kur kërkohej nga ligji, anëtarët e Këshillit Mbiqyres dhe të Bordit Drejtues ndalohen të transmetojnë të të tretet informacionin që demton interesat e shoqërisë. Anëtarët e Këshillit Mbiqyres dhe të Bordit Drejtues detyrohen të ruajnë informacionin edhe me largimin e tyre nga këto organe.

Neni 20 - Nenshkrimet e autorizuar

Në bazë të dispozitave të këtij statuti dhe vendimeve të Këshillit Mbiqyres, shoqëria përfaqësohet dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime nga nenshkrimi i autorizuar si më poshtë:

- a. Me nenshkrim të rangut të parë dhe të vetëm nga Kryetari i Bordit Drejtues;
- b. Me nenshkrim të rangut të dytë dhe së bashku të Zëvendës Kryetarit i Bordit Drejtues. Në mungesë të Zëvendës Kryetarit i Bordit Drejtues nenshkrimi i dytë zëvendësohet nga nepunës i lartë të autorizuar nga Kryetari i Bordit Drejtues;

Këshilli Mbiqyres me propozim të Kryetarit të Bordit Drejtues përcakton nenshkrimet e autorizuar sipas nivele të drejtimit dhe administrimit të shoqërisë.


Neni 21 - Komitetet

Këshilli mbiqyres krijon komitete për administrimin e veprimtarisë së shoqërisë. Komitetet përbehen nga jo më pak se tre persona dhe kryesohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

KONTABILITETI, VITI FINANCIAR DHE LLOGARITË VJETORE, FITIMET DHE HUMBJET, FONDET REZERVE

Neni 22 – Kontrolli brendshëm

1. Shoqëria ka komitet kontrolli. Komiteti i kontrollit përbëhet nga tre anëtarë që emërohen nga asambleja e aksionerëve dhe ka këto detyra:
 - a) Kontrollon dhe mbikëqyr procedurat kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë procedurat e vendosura nga IIPPS, si dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre procedurave dhe kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse.
 - b) Kontrollon zbatimin e rregulloreve e të akteve të tjera dhe i raporton këshillit mbiqyres të shoqërisë.
 - c) Jep mendime për të gjitha problemet që i kërkojnë nga këshilli mbiqyres i shoqërisë.
2. Komiteti i kontrollit mbledhet jo më pak se tre herë në vit në mbledhje të zakonshme dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga Këshilli Mbiqyres. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Abstenime nuk lejohen.

- 
3. Komiteti i kontrollit, me kërkesën e tij, ndihmohet nga ekspertë, që emërohen nga këshilli mbikeqyres.
 4. Komiteti i kontrollit ushtron funksionet ne shoqeri ne perputhje me rregulloren te miratuar nga Keshilli mbikeqyres. Keshilli mbikeqyres rregullon veprimtarine e Komitetit te Kontrollit ne baze te propozimeve te Komitetit te Kontrollit.
 5. Komiteti i kontrollit raporton dhe informon Keshillin Mbikeqyres mbi veprimtarine e shoqerise ne cdo mbledhje te tij.
 6. Asambleja e aksionerëve percakton shpërblimin për anëtarët e komitetit të kontrollit.

Neni 23 – Kontrollori i jashtem

- 1 Llogaritë kontabël dhe raportet financiare te shoqerise duhet të jenë në formë dhe përmbajtje në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ndërkombëtare, duke respektuar rregullat e përgatitjes dhe paraqitjes së llogarive kontabël të bankës, përfshirë krijimin e fondeve rezervë të duhura për aktivet e këqija e të dyshimta, si dhe për njohjen e të ardhurave e shpenzimeve.
- 2 Shoqeria emëron ekspert kontabël të autorizuar, Z.Kosta Nika me No.3 License. Eksperti kontabël i autorizuar duhet:
 - a) të ndihmojë për mbajtjen në mënyrën e duhur të llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare;
 - b) të përgatitë raport vjetor së bashku me opinionet e kontrollit, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të bankës, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare në zbatim të dispozitave të këtij ligji;
 - c) të shqyrtojë mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe të praktikave e procedurave kontrolluese, si dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.
- 3 Eksperti kontabël i autorizuar informon Asamblene e Pergjithshme dhe Keshillin Mbikeqyres për:
 - a. Informacionet e pergatitura sipas pikes 23.2;
 - b. çdo veprim mashtrues të kryer nga nëpunësi i shoqërisë, si dhe për parregullsitë dhe mangësitë në administrim ose në transaksionet që mund t'i sjellin shoqerise humbje.

Neni 24 - Viti Financiar – Inventari – Llogaritë Vjetore

- 1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti.
- 2 Keshilli Mbikeqyres mban një regjistër të rregullt të pasurisë dhe të aktivitetit të tij, në përputhje me ligjin. Në fund të vitit financiar, Keshilli Mbikeqyres harton inventarin e pasurisë deri në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar.



Neni 25 – Rezultati i Vitit Financiar dhe Përcaktimi i Fitimit

- 1 Keshilli Mbiqyres harton bilancin vjetor në përputhje me ligjin. 5% e fitimit neto që rezulton nga bilanci i miratuar në bazë të dispozitave të ligjit mbahet për rezervën e domosdoshme.
- 2 Fitimi i mbetur shpërndahet në bazë të vendimeve të Asamblesë së Aksionerëve për shpërndarjen e dividendëve deri në masën 10 % të fitimit neto të shoqërisë apo zërave të tjerë.
- 3 Pjesa e mbetur nga fitimi i shoqërisë pas zbritjes së pjesëve në dy pikat me sipër shkon në përfitim të siguruarve.

Neni 26 – Shpërndarja, Bashkimi, Shkrirja, Paaftësia Paguese, Nderprerja e Pagesave dhe Likuidimi

- 1 Shoqëria quhet e mbyllur në rastet e parashikuara në ligj. Në rast mbyllje, mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve emëron një apo më shumë likuidatorë, duke u dhënë atyre kompetencat përkatëse.
- 2 Shoqëria mund gjithashtu të shpërndahet apo të bashkohet me një tjetër me vendim të mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.

Neni 27 - Dispozita Përfundimtare

- 1 Në rast se ka mospërputhje midis dispozitave të këtij statuti dhe marrëveshjes së ortakeve atëherë zbatohen dispozitat e aktit të fundit.
- 2 Në rast se ka mospërputhje midis dispozitave të këtij statuti, atëherë këto dispozita interpretohen në kuptimin e këtij statuti, sipas qëllimit të asaj pjesë të statutit të ciles i përket, në harmoni me pjesët e tjera të këtij statuti dhe në përputhje me ligjin.
- 3 Në rast se ka mosmarrëveshje në ushtrimin e pushteteve sipas këtij statuti apo çdo lloj akti tjetër në zbatim të këtij statuti, atëherë palet e interesuar i drejtohen Asamblese së Aksionerëve.
- 4 Në rast se ka çeshtje të cilat nuk rregullohen nga ky statut, ose në rast se ka çeshtje të cilat janë pjesërisht të rregulluara nga ky statut, atëherë këto çeshtje rregullohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe, përveç rasteve kur behen vetëm me ndryshim të këtij statuti, me aktet e tjera të Shoqërisë në zbatim të këtij statuti.
- 5 Me zoterimin e aksionit në “shoqëri”, aksioneri pranon statutin dhe çdo ndryshim të statutit të “shoqërisë” .
- 6 Ky statut hyn në fuqi në datën e regjistrimit në regjistrin tregtar.
- 7 Çdo ndryshim në dispozitat e këtij statuti hyn në fuqi :

- a) ne daten e regjistrimit ne regjistrin tregtar ne rast se ndryshojne regjistrimet ne regjistrin tregtar;
- b) ne daten e percaktuar nga asambleja e jashtezakonshme ne rast se nuk ndryshojne regjistrimet ne regjistrin tregtar.

A K S I O N E R E T

1. Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarjeve Perfaqesuar nga Jeffrey Griffin

2. Artan Niko Dulaku ADMINISTRATOR ARTAN DULAKU SH.P.K.

Tirane, me _____/_____/2005

Regjistrimi
18 KORRIK 2005



KËRKESË

PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

GJYKATËS SË RRETHIT

TIRANË

Slu

E nderuar Gjykate,

Shoqëria Tregtare Anonime "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" SH.A.", si shoqëri në krijim e siper, synon të ushtrojë aktivitetin e saj sipas objektit të veprimtarisë të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria, në momentin e krijimit ka kapitalin themeltar të nënshkruar në shumën 70.000.000 (shtatëdhjetë milion lekë), kapital ky, i cili në momentin e themelimit është paguar ne masen 35.7% nga aksionerët.

Në momentin e krijimit Shoqëria përbëhet nga aksionerët

*toe regjistruar nelepe
dheher kryetar Bordit
Drejtues me 18-07-2005*

1. Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarjeve
Me përfaqësues ligjor Z. Jeffrey Griffin
2. Artan Dulaku Sh.p.k.
Me Administrator Z. Artan Dulaku

Godshelaku

*1) Akti i krijimit i
Kryetar (Akti + Akti i
Kryetarit)*

ijithashtu me Vendim të Asamblesë së Aksionerëve është zgjedhur Këshilli Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga:

- | | |
|--------------------|-------------|
| 1. Jeffrey Griffin | Kryetar |
| 2. Artan Dulaku | Zv/ Kryetar |
| 3. Adrian Dulaku | " |
| 4. Greta Angjeli | " |
| 5. Martin Mata | " |
| 6. Ridvana Mara | " |
| 7. Arian Leskaj | " |

*2) Protokolli nr 3924/1218 dt 6/4/2005
U. Soderby*

*3) Protokolli nr 5024/1570 dt 11-9-2005
U. Soderby*

*4) Logjtimi i Organizatës së
Bordit Amerikan me
000TRR051P20007 dt 11-02-2005
nr 000 CBSK051P20083*

5) Bordi Amerikan dt 12-07-2005

Z. Jeffrey Griffin është zgjedhur Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës.

6) Akti nr 2 dt 11/4/2005

Këshilli Mbikëqyrës ka zgjedhur Bordin Drejtues i cili përbëhet si më poshtë

1. Kryetar i Bordit Drejtues

*1) Akti themelues + Statuti
Arian Kraja*

8) vendim 33729 dt 14-6-2005

9) Akti themelues

U. Soderby

2. Zv/Kryetar i Bordit Drejtues
dhe Drejtor i Departamentit të
Operacioneve Monetare dhe Financës Fatmir Sulo

3. Drejtori i Departamentit të Marketingut
të Shërbimeve Logjistike. Dritan Lama

Me cilësinë e Kryetarit të Bordit Drejtues është emëruar Z. Arian Kraja, i datëlindjes 10 Gusht 1965, Lindur në Tiranë dhe banues në Rr.Pjeter Bogdani, P. 7/1, Tiranë

"INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" SH.A." do të ushtrojë aktivitetin e saj pa afat. Selia qendrore e "INSTITUTI AMERIKAN I PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE TË SHQIPËRISË" SH.A." do të jetë në adresën Rr. "Dervish Hima", Nr.11/k, në Tiranë. Shoqëria në ardhmen do të hapë filjale apo degë të saj edhe në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë, edhe jashtë saj.

Nga ana jonë është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm (Akti i Themelimit dhe Statuti) për krijimin e Shoqërisë, të cilin ia paraqesim kësaj gjykate bashkëlidhur kërkesës.

Persa me sipër kërkojmë nga ana juaj njohjen dhe regjistrimin në Regjistrin Tregtar si person juridik të kësaj shoqërie si Shoqëri Tregtare Anonime.

Kerkuesit

F O N D I
SHQIPTARO AMERIKAN
I NDERMARJEVE
TIRANE ALBANIA


